



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0253

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Kryesuese, Isa Hasani dhe Vedat Potoqi-Anëtar të Panelit Shqyrtues, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) K.Regjionale e Mbeturinave" Pastrimi " SH.A., kundër Njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tenderit të Kuvendi i Komunës së Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Menaxhimi i mbeturinave me numër të prokurimit 616-24-11988-2-1-1, me 16/06/2025, mori:

Vendim

1. Jashtë Juridiksionit për shqyrtim ankesa e OE K.Regjionale e Mbeturinave" Pastrimi " SH.A. me nr. 2025/0253 , e datës 08/04/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Menaxhimi i mbeturinave me numër të prokurimit 616-24-11988-2-1-1.
2. Ankuesi lidhur me këto veprime të AK mund ti drejtohet institucioneve tjera kompetente për mbrojtjen e të drejtave të tij/saj.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik K.Regjionale e Mbeturinave" Pastrimi " SH.A.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 18/11/2024, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Menaxhimi i mbeturinave me numër të prokurimit 616-24-11988-2-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 16,500,000.00 €.

Me 26/03.2025, OE K.Regjionale e Mbeturinave" Pastrimi " SH.A. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 01/04/2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 08/04/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE K.Regjionale e Mbeturinave" Pastrimi " SH.A. me nr. 0253/2025 për lidhur me aktivitetin Menaxhimi i mbeturinave me numër të prokurimit 616-24-11988-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa nuk i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP-së në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP në mungesë të petitumit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues K.Regjionale e Mbeturinave" Pastrimi " SH.A janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi : “KRM “Pastrimi” SH.A kundërshton vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, të datës 01.04.2025, duke e konsideruar si arsyetim formal dhe pa mbështetje ligjore. Sipas ankesës, AK ka deklaruar se aktiviteti i prokurimit është monitoruar nga KRPP, çka sipas ankuesit është e pavërtetë. Në mbështetje të këtij pretendimi, ankuesi ka dorëzuar komunikim zyrtar nga KRPP që mohon përfshirjen në këtë proces. Ankuesi vlerëson se vendimi i AK-së është ndërtuar mbi supozime dhe jo mbi fakte konkrete, duke rezultuar në një vlerësim të gabuar si në aspektin faktik ashtu edhe në atë juridik.”

Pretendimi : “KRM “Pastrimi” SH.A konteston ligjshmërinë e shpalljes së aktivitetit të prokurimit nga Komuna e Prishtinës, duke u mbështetur në rregulloret komunale në fuqi (Nr. 01-030/01-227581/23 dhe ndryshimet përkatëse të vitit 2024), të cilat e përcaktojnë atë si ofruesin ekskluziv të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave në territorin komunal. Sipas ankuesit, shpallja e tenderit më 18.11.2024 bie ndesh me këto akte normative, duke përbërë shkelje të parimit të ligjshmërisë dhe duke krijuar dyfishim të panevojshëm të shërbimit. Ankuesi ka bashkangjitur në ankesë kopje të rregulloreve komunale përkatëse, të cilat janë ende në fuqi dhe nuk janë shfuqizuar. Në këtë bazë, ai kërkon nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së që të konstatojë paligjshmërinë e aktivitetit dhe të urdhërojë anulimin e tij.

Pretendimi

Pretendimi

Pretendimi i peste (V) ankuesi pretendon se: “KRM “Pastrimi” SH.A pretendon se Komuna e Prishtinës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka shkelur dispozitat e nenit 9, paragrafi 4 të LPP-së, duke mos shqyrtuar mundësinë e aplikimit të një kontrate “në shtëpi” përpara shpalljes së aktivitetit të prokurimit për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave. Ankuesi thekson se Komuna është aksionare shumicë e ndërmarrjes publike “KRM Pastrimi” SH.A, e cila aktualisht ofron këtë shërbim dhe është përcaktuar si ofrues ekskluziv në rregulloret komunale në fuqi. Në këtë kontekst, Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar të shqyrtonte nëse nevojat mund të përmbusheshin përmes një autoriteti tjetër publik – konkretisht përmes ndërmarrjes në pronësinë e saj. Sipas ankuesit, në vend të kësaj, Komuna ka iniciuar një procedurë të hapur tenderimi për përfshirjen e operatorëve privatë, pa ndërmarrë vlerësimet paraprake që kërkon neni 9.4 i LPP-së dhe pa dokumentuar asnjë analizë për kapacitetet ekzistuese të ndërmarrjes publike. Në dosjen e tenderit mungon çdo referencë që tregon se është shqyrtuar ekzistenca dhe kapaciteti i

ndërmarrjes "KRM Pastrimi" SH.A si ofrues aktual i shërbimit, gjë që, sipas ankuesit, përbën shmangie të qëllimshme të fakteve materiale. Në mbështetje të pretendimit të tij, ankuesi i referohet edhe Interpretimit Nr. 1 të KRPP-së të datës 22.11.2022, sipas të cilit: "Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t'u siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik." Sipas ankuesit mbështetur në interpretimin e KRPP, nëse ekziston një autoritet publik që ofron shërbimin përkatës, nuk ka nevojë të zhvillohet procedurë tenderimi, pasi marrëdhënia kontraktuale mund të vendoset përmes modelit të "kontratës në shtëpi". Në përfundim, ankuesi konsideron se veprimet e AK-së janë në kundërshtim me nenin 9.4 të LPP-së dhe me frymën e menaxhimit të qëndrueshëm dhe ekonomik të fondeve publike. Ai kërkon që aktiviteti i prokurimit të shpallet i paligjshëm dhe që OSHP-ja të urdhërojë shqyrtimin e mundësisë për aplikimin e modelit të kontratës "në shtëpi", në përputhje me legjislacionin dhe interpretimin përkatës të KRPP-së."

Duke u referuar pretendimeve si më sipër OE K.Regjionale e Mbeturinave" Pastrimi " SH.A. konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 2, 6, 7, 8, 9.4, 9.5, 10, 12.1 të LPP-se si dhe nenin 82, 83, 84, 85 të Rrpp-se. Duke u mbështetur në të gjitha sa më sipër, si dhe në faktet e pakundërshtueshme që dëshmojnë shkelje të rëndë të legjislacionit në fuqi, kërkojmë: Anulimin e menjëhershëm të aktivitetit të prokurimit publik me titull: "Menaxhimi i mbeturinave", me nr. 616-24-11988-2-1-1. Detyrimin e Komunës së Prishtinës për të zbatuar Rregulloren në fuqi për menaxhimin e mbeturinave, duke kontraktuar shërbimet në përputhje me këtë akt. Ndërmarrjen e veprimeve përkatëse për pezullimin e licencës së prokurimit sipas ligjit ndaj zyrtarit të prokurimit të Komunës së Prishtinës, për keq menaxhim, mungesë transparence dhe dëmtim potenciali të buxhetit të Republikës së Kosovës. Hetimin e plotë të kësaj procedure nga OSHP dhe KRPP, për të verifikuar përputhshmërinë me LPP dhe për të parandaluar abuzime të mëtejme me fondet publike.

Përgjigje ne kërkesën për Rishqyrtim: "Operatori ekonomik "Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastrimi ShA" (tutje "parashtruesi") me datë 26.03.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Menaxhimi i mbeturinave" me nr. të prokurimit 616-24-11988-2-1-1. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtresit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtuar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtresit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (in merituni) të kërkesës. Pretendimet e parashtresit: në kërkesë nuk është arritur që të formulohet asnjë pretendim ankimor lidhur me kërkesat e DT. Parashtresit në kërkesën e tij vetëm propozon që të anulohet komplet aktiviteti i prokurimit në fjalë dhe të vazhdohet kontraktimi sipas rregullores së menaxhimit të mbeturinave". Lidhur me pretendimet ankimore të parashtresit, duhet sqaruar se parashtresit funksion si ndërmarrje publike rajonale ku Komuna e Prishtinës ka shumicën e pronësisë respektivisht aksioneve të shoqërisë. Sidoqoftë nuk qëndron argumenti i parashtresit sipas të cilit ky aktivitet është duke u manifestuar me shkelje ligjore dhe të kontratës ndërmjet Komunës së Prishtinës dhe parashtresit. Fillimisht aktiviteti i prokurimit është duke u zhvilluar në përputhje me LPP dhe jo mbi bazën e rregulloreve të brendshme të parashtresit. Për më tepër ky aktivitet i prokurimit është iniciuar me kërkesën e njësisë kërkuese me të cilën ka qenë e bashkangjitur edhe deklarata për disponueshmërinë e fondeve. Ndërsa vet kërkesa e njësisë kërkuese ka qenë e bazuar në vendimin e ZKA - Kryetarit të Komunës së Prishtinës për shpalljen e gjendjes emergjente në fushën e menaxhimit të mbeturinave në kryeqytet. Vlen të shtohet se ky aktivitet i prokurimit është duke u monitoruar edhe nga KRPP por tanimë ka kaluar edhe fazën e shqyrtimit të një

ankese në OSHP. Në asnjë rast këto organe mbikëqyrëse në fushën e prokurimit publik nuk kanë konstatuar se janë plotësuar kushtet sipas nenit 62 të LPP lidhur me nenin 43.8 të RRPP për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Sa i përket vet kërkesës së parashtruesit, duhet fokusuar faktin që në kërkesë nuk është arritur që të formulohet asnjë pretendim ankimor lidhur me kërkesat e DT. Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.”

OSHP me datë 10/04/2025 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0253/2025, ndërsa me datë 18/04/2025 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 0253/2025, me rekomandimet si në vijim: Eksperti shqyrtues, duke u mbështetur në të gjeturat e paraqitura më sipër, i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e operatorit ekonomik KRM “Pastrimi” SH.A të vlerësohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht, rekomandohet që njoftimi për kontratë të anulohet dhe që lënda t’i kthehet Autoritetit Kontraktues për rishqyrtim, me qëllim që ky i fundit të rivlerësojë zhvillimin e mëtejshëm të aktivitetit të prokurimit në përputhje me nenin 9.4 të LPP-në.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk ka kthyer përgjigje lidhur me raportin e eksperti shqyrtues. Ndërsa OE është pajtuar me rekomandimin e ekspertit.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtruesat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “K.Regjionale e Mbeturinave” Pastrimi ” SH.A eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0253 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i pare (I): “Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i KRM “Pastrimi” SH.A, megjithëse nuk ka qenë pjesë e kërkesës fillestare për rishqyrtim në përputhje me nenin 64.2 të Rregullores Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik (RrPP) dhe nenin 13, paragrafi 9 të Rregullores së Punës së OSHP-së është i arsyeshëm për shqyrtim sepse ka lindur si reagim ndaj përmbajtjes së vendimit të AK-së të datës 01.04.2025, si përgjigje ndaj kërkesës për rishqyrtim dhe për këtë arsye është konsideruar i justifikuar për trajtim në kuadër të shqyrtimit të përgjithshëm të procedurës.

Në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, AK ka deklaruar se aktiviteti i prokurimit është “duke u monitoruar nga KRPP”. Ankuesi ka dorëzuar komunikim zyrtar nga Njësia e Monitorimit e KRPP-së, të datës 29.03.2025, në të cilin konfirmohet se aktiviteti në fjalë nuk është dhe nuk ka qenë objekt monitorimi nga ky institucion. Bazuar në këtë dokumentacion, rezulton se deklarata e përfshirë në vendimin e AK-së nuk përputhet me të dhënat zyrtare të disponueshme. Sipas nenit 108/A të LPP-së, autoritetet kontraktuese kanë për detyrim që vendimet e tyre t’i bazojnë në fakte të sakta dhe të arsyetueshme. Duke marrë parasysh rëndësinë që ka saktësia e informacionit në dokumentet zyrtare të një procedure prokurimi, eksperti shqyrtues

vlerëson se deklarata e përfshirë në vendimin e AK-së nënvizon nevojën për kujdes të shtuar gjatë formulimit të vendimeve dhe referencave institucionale. Përgjegjësia për përmbajtjen e saktë i takon autoritetit përkatës dhe zyrtarëve të tij, në përputhje me kërkesat ligjore për bazimin e vendimeve në të dhëna të sakta dhe të verifikuara. Ndërkohë, edhe pse OSHP-ja nuk ka mandat për të ndërhyrë në marrëdhëniet ndërinstitutionale, në raste kur institucione si KRPP janë në dijeni për referenca të pasakta që lidhen me rolin apo veprimet e tyre, një sqarim zyrtar dhe në kohë nga aga e tyre do të ishte i dobishëm për rritjen e transparencës dhe për shmangien e paqartësive në dokumentacionin zyrtar të prokurimit.”\

Konstatimi i dyte (II): “Lidhur me pretendimin e paraqitur nga KRM “Pastrimi” SH.A, që ka të bëjë me kontestimin e ligjshmërisë së aktivitetit të prokurimit të iniciuar nga Komuna e Prishtinës më datë 18.11.2024, eksperti shqyrtues ka analizuar dokumentacionin e ankesës dhe dokumentet përkatëse të prokurimit. Ankuesi pretendon se Komuna e Prishtinës ka vepruar në kundërshtim me Rregulloren Komunale Nr. 01-030/01-227581/23 të datës 01.12.2023 dhe me ndryshimin e saj përmes Rregullores Nr. 01-030/01-161704/2024 të datës 06.12.2024, të cilat i japin KRM “Pastrimi” SH.A të drejtë ekskluzive për ofrimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave në territorin komunal. Në mbështetje të këtyre rregulloreve, ankuesi kërkon konstatimin e paligjshmërisë së aktivitetit të prokurimit dhe anulimin e tij. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, eksperti shqyrtues vlerëson se rregulloret e lartpërmendura janë të miratuara nga Kuvendi Komunal dhe janë në fuqi. Në përmbajtjen e tyre parashihet se KRM “Pastrimi” SH.A ka të drejtë ekskluzive për ofrimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave, përfshirë faturimin dhe inkasimin e tarifës përkatëse. Në përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim, AK nuk ka kontestuar këtë fakt dhe ka pranuar se Komuna e Prishtinës është aksionare shumicë në këtë ndërmarrje publike. Megjithatë, eksperti shqyrtues vlerëson se interpretimi përfundimtar i vlefshmërisë dhe zbatueshmërisë së një akti normativ komunal, përfshirë përputhshmërinë e veprimeve të AK-së me një rregullore të tillë, i takon gjykatave kompetente dhe tejkalon fushëveprimin e shqyrtimit nga OSHP-ja. Në kuadër të kompetencës së tij, eksperti shqyrton nëse AK ka respektuar dispozitat e LPP-së. Në këtë drejtim, eksperti thekson se në dokumentacionin e publikuar në platformën e-prokurimi nuk ekziston ndonjë vlerësim i dokumentuar nga ana e AK-së lidhur me nenin 9.4 të LPP-së, i cili kërkon që, përpara se të iniciohet një aktivitet i prokurimit, të shqyrtohet mundësia që shërbimi të ofrohet nga ndonjë autoritet publik ekzistues. Mungesa e një vlerësimi të dokumentuar në kuptim të nenit 9.4 të LPP-së përbën një mangësi procedurale, veçanërisht në rrethanat kur ekziston një operator publik që është i përcaktuar me Rregullore të Kuvendit Komunal si ofrues i shërbimit. Në këto kushte, veprimet e Autoritetit Kontraktues nuk mund të vlerësohen plotësisht si të përputhshme me kërkesat e ligjshmërisë dhe menaxhimit të drejtë të fondeve publike. Në përfundim, eksperti shqyrtues konstaton se, ndonëse nuk mund të japë një vlerësim përfundimtar mbi vlefshmërinë e rregullores komunale, ekzistenca e saj dhe mungesa e trajtimit të saj në kuptim të nenit 9.4 të LPP-së krijojnë pasiguri rreth ligjshmërisë së procedurës së iniciuar me kërkesat e Ligjit për Prokurimin Publik.”

Konstatimi i trete (III): “Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i parashtruar nga KRM “Pastrimi” SH.A, që lidhet me mospërputhje procedurale dhe kronologjike në zhvillimin e aktivitetit të prokurimit, nuk është i pranueshëm për shqyrtim, pasi nuk është përfshirë më parë në kërkesën për rishqyrtim të dorëzuar pranë Autoritetit Kontraktues. Sipas nenit 64.2 të RrPP-së dhe nenit 13, paragrafi 9 të Rregullores së Punës së OSHP-së Nr. 01/2020, përcaktohet se: “Ankesa duhet të jetë e qartë, e shkurtër dhe me pretendimet e njëjta me ato të paraqitura për autoritetin kontraktues.” Në përputhje me këtë dispozitë, ekspertit shqyrtues nuk i lejohet të trajtojë pretendime të reja që nuk janë ngritur në kërkesën për rishqyrtim të datës 26.03.2025.

Meqenëse pretendimi për mospërputhjen ndërmjet datave të emërimit të komisionit punues dhe publikimit të njoftimit për kontratë nuk është përmendur në atë kërkesë, ai konsiderohet i papranueshëm për shqyrtim nga OSHP-ja.”

Konstatimi i katërt (IV): “Pas analizës së dokumentacionit përkatës dhe pretendimeve të parashtruara nga operatori ekonomik “KRM Pastrimi” SH.A, eksperti shqyrtues vlerëson si më poshtë: 1. Lidhur me pretendimin për kosto të pajustifikuar dhe shkeljen e nenit 6 të LPP-së: Ankuesi ka pretenduar se vlera totale e kontratës së planifikuar nga Autoriteti Kontraktues për periudhën 3-vjeçare arrin rreth 21.4 milion euro, duke u bazuar në çmimin për njësi prej 80 €/ton të përcaktuar në tender, si dhe në faktin se bëhet fjalë për një kontratë kornizë, për të cilën – sipas praktikës – mund të zbatohet një devijim deri në +30%. Sipas ankuesit, kjo vlerë maksimale potenciale paraqet një rritje të ndjeshme në krahasim me koston aktuale të shërbimit dhe nuk është e justifikuar në dokumentacionin e tenderit. Ndërkohë, sipas rregullores komunale në fuqi, shërbimi aktual ofrohet me çmim 6.20 euro për njësi banimi, për rreth 72,000 njësi, që përkthehet në rreth 16 milion euro për të njëjtën periudhë. Diferenca prej mbi 5 milion euro, sipas ankuesit, është e pajustifikuar dhe përbën shkelje të nenit 6 të LPP-së, i cili kërkon përdorimin racional dhe ekonomik të fondeve publike. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se Autoriteti Kontraktues ka shpallur aktivitetin e prokurimit në gjashtë LOT-e, me vlerë të përgjithshme të njoftuar prej 16,500,000.00 €. Në dokumentet e tenderit nuk është specifikuar ndonjë përqindje devijimi të lejuar, në përputhje me nenin 54.10 të Rregullores për Prokurimin Publik, i cili përcakton se: “Nëse Autoriteti Kontraktues nuk deklaron përqindjen e mospërputhjes në dosje të tenderit, atëherë kontrata përfundon me vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan të vendosur.” Si i tillë, pretendimi për një vlerë të përgjithshme prej 21.4 milion euro mbetet i pambështetur në dokumentacionin zyrtar të tenderit dhe nuk mund të vlerësohet si shkelje e drejtpërdrejtë e dispozitave ligjore. Gjithashtu, nuk është paraqitur ndonjë analizë krahasuese që të lidhë në mënyrë të argumentuar metodologjinë e çmimit për njësi banimi me çmimin për ton të përdorur në këtë procedurë. 2. Lidhur me shmangien e autoritetit publik ekzistues (neni 9.4 dhe neni 7 i LPP-së): Ankuesi pretendon se Autoriteti Kontraktues ka anashkaluar ndërmarrjen publike “KRM Pastrimi” SH.A – e cila është në pronësi të Komunës së Prishtinës dhe që aktualisht ofron shërbimin – duke mos shqyrtuar mundësinë për kontratë “në shtëpi”. Kjo, sipas tij, përbën shkelje të nenit 9.4 dhe cenim të parimit të trajtimit të barabartë dhe mos diskriminimit (neni 7 i LPP-së). Eksperti shqyrtues konstaton se në platformën e prokurimit nuk ekziston ndonjë dokument që dëshmon vlerësim paraprak të kësaj alternative nga ana e AK-së. 3. Lidhur me Deklaratën për Nevojat dhe Disponueshmërinë e Fondeve (DNPDP): Ankuesi pretendon se Autoriteti Kontraktues ka iniciuar aktivitetin e prokurimit pa përgatitur ose përfshirë në dokumentacion Deklaratën për Nevojat dhe Disponueshmërinë e Fondeve (DNPDP), siç kërkohet në nenet 9.5 dhe 9.6 të LPP-së, dhe pa kryer vlerësim të nevojave reale sipas nenit 9.3. Eksperti shqyrtues ka verifikuar se në dokumentet e publikuara në platformën zyrtare të prokurimit figuron DNPDP-ja për aktivitetin përkatës, me vlerë të përgjithshme 16,500,000 € për periudhën 2025–2027. Kjo dëshmon se Autoriteti Kontraktues ka përmbushur kërkesat formale që dalin nga nenet 9.5 dhe 9.6 të LPP-së për sa i përket konfirmimit të disponueshmërisë së fondeve si kusht për procedimin e mëtejshëm të tenderit. Megjithatë, në dokumentacion nuk është reflektuar ndonjë analizë e qartë mbi përputhshmërinë buxhetore me planifikimet komunale ekzistuese, dhe nuk figuron një vlerësim i detajuar i nevojave reale që justifikojnë vlerën dhe kohëzgjatjen e kontratës, në përputhje me nenin 9.3 të LPP-së. Po ashtu, mungon trajtimi i mundësisë së ofrimit të shërbimit nga një autoritet publik ekzistues, siç kërkohet me nenin 9.4 të LPP-së.”

Konstatimi i peste (V): “Eksperti shqyrtues sqaron se vlerësimi i nevojës për ushtrimin e një procedure të prokurimit është përgjegjësi e Autoritetit Kontraktues. Megjithatë, kjo kompetencë duhet të ushtrohet në përputhje me dispozitat përkatëse të LPP-së, përfshirë nenin 9.4, i cili parashikon se: "Para se të iniciojë një aktivitet prokurimi, autoriteti kontraktues duhet të vlerësojë nëse një autoritet publik tjetër është në gjendje të përmbushë atë nevojë dhe, nëse po, duhet të konsiderojë mundësinë e një marrëveshjeje ndërmjet autoriteteve publike." Në dokumentacionin e publikuar në platformën zyrtare të prokurimit, përveç deklaratës në pikën II.1.6 të DNPDP-së ku thuhet: "Për shkak të problemeve serioze është krijuar gjendje e rëndë me menaxhim të mbeturinave në qytet dhe si pasojë është shpallur gjendje e jashtëzakonshme me vendim të datës 14.02.2024 me nr. 14-352/01-24484/24, andaj shpallja e kësaj procedure të prokurimit është e domosdoshme", nuk gjendet asnjë dokument tjetër që të dëshmojë se është shqyrtuar alternativa për kontratë "në shtëpi" me ndërmarrjen publike “KRM Pastrimi” SH.A. Po ashtu, nuk është evidentuar ndonjë vlerësim apo analizë e dokumentuar që të dëshmojë se janë marrë në konsideratë kapacitetet ekzistuese të kësaj ndërmarrjeje në kuadër të procesit të vendimmarrjes. Ky aspekt do të kishte qenë veçanërisht relevant, duke pasur parasysh se Komuna e Prishtinës është aksionare shumicë në këtë ndërmarrje publike. Autoriteti Kontraktues ka për detyrë të sigurohet se procedura e iniciuar është në përputhje me nenin 9.4 të LPP-së dhe me udhëzimet e dhëna në Interpretimin Nr. 1 të KRPP-së të datës 22.11.2022, i cili thekson se autoritetet publike duhet të ndërmarrin masa të arsyeshme për tu siguruar se shërbimi përkatës nuk është i disponueshëm nga ndonjë autoritet tjetër publik përpara se të iniciojnë një procedurë prokurimi. Në mungesë të një arsytimi të tillë në dokumentacionin zyrtar, dhe duke pasur parasysh praktikën e mëparshme të OSHP-së në trajtimin e rasteve të ngjashme që lidhen me detyrimet e Autoritetit Kontraktues për të shqyrtuar alternativën publike sipas nenit 9.4 të LPP-së – siç janë vendimi nr. 163/18 dhe vendimi nr. 373/20 – eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i paraqitur nga ankuesi është i bazuar.”

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues K.Regjionale e Mbeturinave" Pastrimi " SH.A. Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e eksperteve mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur abesimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues K.Regjionale e Mbeturinave" Pastrimi " SH.A. janë pjesërisht të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Sipas ankesës me nr 2025/0253 , e datës 08/04/2025 nga OE K.Regjionale e Mbeturinave" Pastrimi " SH.A lidhur me aktivitetin e prokurimit Menaxhimi i mbeturinave me numër të prokurimit 616-24-11988-2-1-1.

Paneli Shqyrtues i OSHP-së ka analizuar ankesën e Kompanisë Rregjionale të Mbeturinave “Pastrimi” në lidhje me kundërshtimin e publikimit të njoftimit për kontratë nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës lidhur me shërbimet e menaxhimit të mbeturinave.

Lidhur me këtë ankesë Paneli Shqyrtues ka mbajtur dy seanca degjimore, OE Kompania Regjionale e Mbeturinave" Pastrimi " SH.A ka pretenduar se publikimi i kësaj procedure nga

AK-KOMUNA E PRISHTINËS është në kundërshtim me Rregullorën Komunale nr. 01-030-/01-227581/23 dhe ndryshimet përkatëse të vitit 2024 e cila është ende në fuqi , Rregullore e cila përcakton se ofruesi ekskluziv i shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave në territorin e komunës është Kompania Regjionale e Mbeturinave" Pastrimi " SH.A ". Paneli pas ndëgjimit të të gjitha palëve në procedurë konsideron se kjo çështje tejkalon kompetencat shqyrtuese të OSHP-së, për çka PSH i shqipton vërejtje Zyrës së Pranimi pranë OSHP-së, e cila pa ndonjë analizë të mirfillët ka futur në trajtim fillestar ankesën në kundërshtim me nenin 4, 108/A , 109, 111 dhe 113 të LPP -së, dhe Rregullorës nr 01/2020 e Punës së OSHP-së.

Paneli shqyrtues vëren se Komuna e Prishtinës në cilësinë e autoritetit kontraktues ka publikuar, Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “ Menaxhimi i mbeturinave “i caktuar ne 6 Lot. Operatori ekonomik Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” SHA, me ankesën e saj te paraqitur ne OSHP, e ka kontestuar aktivitetin e prokurimit me arsyetim se është” Shkelje e vendimeve dhe rregulloreve komunale në fuqi – KRM “Pastrimi” ka të drejtë ekskluzive për menaxhimin e mbeturinave në Prishtinë sipas rregulloreve të Kuvendit Komunal”, dhe ”Kërkesa për anulimin e aktivitetit të prokurimit – Kërkohet nga OSHP që të anulohet menjëherë aktivitetin e prokurimit dhe të detyrojë Komunën të veprojë sipas rregullores në fuqi”.

Paneli shqyrtues lidhur me pretendimin e ankuesit se autoriteti kontraktues Komuna e Prishtinës, lidhur me këtë aktivitet prokurimi nuk ka vepruar ne përputhje me Rregullorën për Menaxhimin e Mbeturinave(Rregullorja), me rastin e publikimit te këtij aktiviteti te prokurimit, Paneli shqyrtues vëren se Rregullorja ne fjale është një akt nënligjor i brendshëm i AK/Komuna e Prishtinës dhe ne këtë rast konstatohet se OSHP- me rastin e trajtimit të kësaj ankese nuk mund ti referohet kësaj Rregullore, pasi OSHP pretendimet ankimor i shqyrton mbi bazën ligjore; Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092; Rregulloren për Punën e Organit Shqyrtues të Prokurimit, Nr. 83/20, e datës 03.03.2020, Rregulloren për Prokurim Publik Nr. 002/2024, e datës 11.11.2024, për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, e datës 20.10.2022 dhe Udhëzues Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, i datës 01.02.2023, andaj dhe pretendimi ankimor është jashtë kompetencave ligjore të OSHP-së.

Shqyrtimi i kësaj ankese nga ana e Organit Shqyrtues të Prokurimit është jashtë fushës së kompetencave dhe autorizimeve ligjore të përcaktuara me Ligjin Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, si dhe me legjislacionin sekondar në fuqi që rregullon procedurat dhe veprimtarinë e këtij organi. Sipas dispozitave të këtij ligji dhe aktet nënligjore përkatëse, kompetencat e Organit Shqyrtues janë të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe të kufizuar vetëm për shqyrtimin e çështjeve që lidhen drejtpërdrejt me procedurat e prokurimit publik brenda kornizës ligjore të përcaktuar. Çdo pretendim që tejkalon këto kufizime, përfshirë edhe shqyrtimin e çështjeve jashtë fushës së prokurimit publik ose jashtë kompetencave të përcaktuara ligjore, konsiderohet jashtë juridiksionit të këtij organi.

Përveç tjerash, Paneli shqyrtues thekson se edhe vetë kërkesa e ankuesit, që OSHP ta anulohë aktivitetin e prokurimit te AK/Komuna e Prishtinës” Menaxhimi i mbeturinave” dhe mos kontestimi i asnjë nga kërkesat e Dosjes se tenderit/Njoftimit per kontratë, është në kundërshtim edhe me nenin 108/A. Andaj, mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë përcaktuar në mënyre të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër. Sikurse mund të kuptohet edhe nga përmbajtja e ankesës, në kontekstin shpjegimeve

konform nenit 103, të LPP, sipas të cilit, “Dispozitat e kësaj pjese përcaktojnë të drejtat themelore dhe procedurale dhe mjetet juridike në dispozicion të palëve të interesuara siç është përkufizuar ky term (“palë e interesuar”) në nenin 4 të këtij ligji”. Kuptimi i kësaj dispozite vërteton fare qartë se, mjetet juridike mund të vihen në lëvizje vetëm nga palët e interesuara duke ju referuar në këtë rast pikërisht përkufizimit të dhënë në nenin 4, të LPP. Andaj, operatori ekonomik ankues me rastin e parashtrimit të kësaj ankese ka kërkuar në petitumin e saj që ky aktivitet i prokurimit të anulohet në tërësi, me këtë veprim OE ankues nuk ka arritur të dëshmoi interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit. Andaj paneli shqyrtues operatorin ekonomik ankues për këtë aktivitet të prokurimit e vlerëson si palë pa interes juridiko material, konform nenit 4, paragrafi 1.26 i LPP-së, i cili citon: “Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar.” Ky konstatim mbështet edhe tek neni 31, paragrafi 2 i Rregullores së Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit nr.83/20.

Mbi bazën e kompetencave ligjore, Paneli Shqyrtues vlerëson se pretendimet ankimore të ankuesit janë të drejtuara në ligjshmërinë e aktit administrative (Rregullorën) të autoritet kontraktues Komuna e Prishtinës, për publikimin e aktivitetit të prokurimit. Paneli konstaton se kontestimi i ligjshmërisë së aktit administrative të Komunës së Prishtinës përkatësisht të vlefshmërisë dhe ligjshmërisë së tij/saj nuk është në kompetencën ligjore të Organit të Shqyrtimit Prokurimit, por i përket mbikëqyrjes administrative të aktit nga ana e institucioneve tjera, në këtë rast kompetencës së ligjore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Rregullorja e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, me Nenin 8 ka përcaktuar se shqyrtimin e detyrueshëm të ligjshmërisë së akteve të kuvendit të komunave, si; Statutit, Rregullores së Komunave, vendimeve të përgjithshme të kuvendit të komunave dhe akteve tjera. Ministra e Administrimit të Pushtetit Lokal, me këtë rast është autoriteti ligjor i cili e ka autorizime ligjore të mbikëqyrjes së ligjshmërisë së akteve juridike të nxjerra nga komunat e Kosovës. Po ashtu edhe në seancën shqyrtues publike të mbajtur në OSHP, eksperti shqyrtues deklaroi se KRPP nuk e ka monitoruar dhe nuk është në proces të monitorimit të këtij AK. Në nenin 87 të LPP 1”.KRPP është përgjegjëse për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik në Kosovë, dhe i ushtron funksionet që i jepen nga ky ligj.2.1. të kryej monitorimet e aktiviteteve të prokurimit dhe menaxhimin të kontratave për qëllim të monitorimit të zbatimit të këtij ligji” dhe ky aktivitet prokurimi ka vazhduar në procedura të metejme.

Duke u mbështetur në gjetjet faktike dhe juridike të sipërcekura, OSHP vendos:

- Të mbyllë këtë rast për shkak të mungesës së juridiksionit ligjor për të shqyrtuar çështje që kanë burim nga aktet normative komunale me efekt të drejtpërdrejtë.
- Ndërsa ankuesi për realizimi e të drejtës së tij/saj mund të drejtohet institucioneve kompetente.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë

një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - K.Regjionale e Mbeturinave" Pastrimi " SH.A.**
- Arkivës së OSHP-së: